

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PaKr 1/13

Më: 16 prill 2014

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it James Hargreaves si kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues, gjyqtarja e EULEX-it Annemarie Meister dhe gjyqtari kosovar i Gjykatës së Apelit Xhevdet Abazi, si anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor të EULEX-it Andres Parmas në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën penale kundër:

L.J., i liruar në shkallën e parë nga këto vepra penale:

- *Kryerje në tentativë e terrorizmit në bashkëkryerje* në kundërshtim me nenin 2.3 dhe 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/12 dhe nenet 19 dhe 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë – KP RSFJ, lidhur me nenet 20, 23 dhe 110 (1) dhe (3) të Kodit Penal të Kosovës (KPK):
- *Terrorizëm* në kundërshtim me nenet 2.4 dhe 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/12;
- *Kryerje në tentativë e terrorizmit në bashkëkryerje* në kundërshtim me nenet 4.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/12, lidhur me nenet 1 dhe 2 të Urdhëresës Administrative (UD) nr. 2003/12, lidhur me nenet 1 dhe 2 të UD-së nr. 2003/12 dhe nenin 22 të KP të RSFJ-së, lidhur me nenet 2, 23, 109 dhe 112 (5) të KPK-së;
- *Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve* në kundërshtim me nenin 8.2, lidhur me nenin 8.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/7, lidhur me nenet 2 dhe 328 (2) të KPK-së;
- *Organizim, mbështetje dhe pjesëmarrje në grupet terroriste* në kundërshtim me nenin 5.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/12, lidhur me nenet 2, 109 dhe 113 të KPK-së;
- *Kryerje në tentativë e veprës penale të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm në bashkëkryerje* në kundërshtim me nenin 157 (1), lidhur me nenin 164 (2) dhe nenet 19 dhe 22 të KP të RSFJ-së, lidhur me nenet 2, 20, 23 dhe 291 (5) të KPK-së;

Duke vendosur rreth ankesës së prokurorit special Besim Kelmendi të parashtruar më 10 janar 2013 kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit nr. P 107/05 të datës 9 tetor 2012;

Duke pasur parasysh përgjigjen ndaj ankesës së avokatit mbrojtës Nasuf Nasufi të parashtruar më 14 janar 2013;

Duke pasur parasysh edhe mendimin e prokurorit të apelit në kuadër të prokurorisë së shtetit, nr. PAR/I. 33/13 të dorëzuar në Gjykatën e Apelit më datën 30 janar 2013;

Pas mbajtjes së seancës publike më datën 16 prill 2014, ku ishin ftuar me kohë të gjitha palët, në praninë e prokurorit të apelit Haxhi Derguti;

Pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit më 16 prill 2014;

Në bazë të nenit 420 dhe neneve në vazhdim të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)

Merr këtë:

A K T G J Y K I M

1. **Refuzohet ankesa e prokurorit special kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit të datës 9 tetor 2012.**
2. **Vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore.**

A R S Y E T I M

I. Procedura e deritanishme

1. Më 31 korrik 2005 është ngritur aktakuza kundër *inter alia* L.J.t pranë Gjykatës së Qarkut të asaj kohe të Gjilanit, me të cilën L.J. akuzohej për veprat penale të theksuara më lart.
2. Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në mes datave 7 dhjetor 2011 dhe 9 tetor 2012, kur është bërë shpallja e aktgjykimit.
3. Gjykata e shkallës së parë e ka liruar L.J.n prej të gjitha akuzave. Gjykata kishte konstatuar se ishin provuar faktet të cilat tregojnë kryerjen e veprës penale të terrorizmit por se këto fakte nuk kishin provuar pohimet e tjera në aktakuzë, duke përfshirë këtu pohimin se i

pandehuri J. ka qenë i përfshirë në krim. Sipas gjykatës, një grup personash të paidentifikuar kanë bërë përgatitjet për të hedhur në erë një pjesë të rrugës në afërsi të portës 5 të vijës kufitare administrative në mes të Kosovës dhe Serbisë. Për arsye të panjohura ata kishin hequr dorë nga plani në fjalë dhe kishin ikur nga vendi i krimit.

4. Gjykata e Qarkut ishte e mendimit se provat e vetme të drejtpërdrejta dhe mundësisht të besueshme të cilat e konfirmojnë pjesëmarrjen e L.J.t në ngjarjet e përshkruara në aktakuzë, vijnë nga dëshmitarët anonimë, policët serbë të cilët i kanë vëzhguar aktivitetet në vendin e ngjarjes. Madje edhe këto dëshmi gjykata i ka konsideruar shumë të dyshimta. Ajo që ka më shumë rëndësi lidhur me këto dëshmi, gjykata e ka theksuar se zbatimi i nenit 157 (3) të KPPK-së si dhe nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nuk lejohet që dikush të shpallet fajtor duke u mbështetur vetëm apo në masë vendimtare në dëshmitë e marra nga dëshmitarët anonimë. Gjykata nuk ka gjetur prova të tjera të besueshme të mjaftueshme për mbështetjen adekuate të dëshmive të dëshmitarëve anonimë.

II. Parashtrësit e palëve

1. Ankesa

5. Më 10 janar 2013, prokurori i PSRK-së ka parashtruar ankesë duke propozuar anulimin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut dhe kthimin e lëndës në rivendosje. Parashtruesi i ankesës pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk i ka dhënë arsyet pse nuk iu është besuar deklaratave të dëshmitarëve të ndryshëm.

2. Përgjigjja e avokatit mbrojtës

6. Mbrojtësi Nasuf Nasufi i është përgjigjur ankesës, duke konstatuar se ankesa është e pabazë dhe si e tillë duhet të refuzohet. Ai ka sugjeruar se gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar saktë faktet, nuk i ka shkelur normat e procedurës penale dhe drejt ka zbatuar ligjin material penal.

3. Mendimi i prokurorit të apelit

7. Prokurori i apelit i propozon Gjykatës së Apelit që ta pranojë ankesën në fjalë. Ai pretendon se gjykata e shkallës së parë vetëm i ka përshkruar provat materiale të gjetura në vendin e ngjarjes, por nuk i ka analizuar ato. Këto prova është dashur të analizohen së bashku me deklaratat e dëshmitarëve. Faktet e lëndës nuk janë vërtetuar drejt nga gjykata e shkallës së parë. Gjykata nuk i ka vlerësuar drejt provat, duke i vlerësuar pa arsye deklaratat e

dëshmitarëve dhe identifikimin e L.J.t nga fotot e paraqitura gjatë fazës së procedurës paraprake, pra afër me kohën kur ka ndodhur ngjarja.

III. Gjetjet e Gjykatës së Apelit

1. Kompetenca e Gjykatës së Apelit

8. Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur rreth ankesës sipas neneve 17 dhe 18 të Ligjit mbi gjykatat (Ligjit nr. 03/L-199).
9. Kolegji i Gjykatës së Apelit është i përbërë në përputhje me nenin 19 (1) të Ligjit mbi gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053).

2. Ligji procedural në fuqi

10. Ligji procedural në fuqi për lëndën penale në fjalë është Kodi (i vjetër) i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), i cili ka qenë në fuqi deri më datën 31 dhjetor 2012.

3. Gjetjet mbi meritat

11. Në këtë lëndë, L.J. është akuzuar për këto vepra: kryerje e terrorizmit; kryerje në tentativë e terrorizmit; mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve; organizim, mbështetje dhe pjesëmarrje në grupet terroriste dhe kryerje në tentativë e shkakimit të rrezikut të përgjithshëm. Të gjitha këto akuza janë ngritur nga incidenti i ndodhur në qershor të vitit 2003 në zonën pranë kufirit me Serbinë.
12. Pas gjykimit publik i cili ka zgjatur dhjetë muaj duke përfshirë gjithsej tetëmbëdhjetë seanca të mbajtura, i pandehuri është liruar nga të gjitha akuzat e trupit gjykues. Prokuroria është ankuar duke pohuar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal dhe vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
13. Për arsyet e përmendura më lart, Gjykata e Apelit e refuzon ankesën e prokurorisë dhe e vërteton aktgjykimin e kundërshtuar të Gjykatës së Qarkut.
14. Ngjarjet faktike të cilat sollën gjer tek kjo lëndë nuk kontestohen – kontestuese është nëse i pandehuri ka qenë një prej bashkëkryerësve.

15. Para analizimit të argumenteve të parashtruesit të ankesës, kolegji shkurtimisht bën një përmbledhje të asaj se çka është vërtetuar nga ana e Gjykatës së Qarkut në aktgjykimin e kundërshtuar.
- 15.1. Vonë pasdite më 6 mars 2003 në afërsi të vijës administrative kufitare në mes të portës 5 (CP 75), midis pikës kontrolluese kosovare dhe serbe pranë Konçulit në Serbi, në largësi është vërejtur një Mercedes i zi që po sillej lart e poshtë rrugës në anën e kufirit të Kosovës. Në fund ky Mercedes u ndal dhe katër persona dolën jashtë prej tij, por ngaqë nuk ishin sa duhet afër fytyrat e tyre nuk mund të shiheshin.
- 15.2. Të katërtit filluan të hiqnin nga bagazhi i veturës telin, një kanistër me karburant dhe një kuti dhe i vendosën këto materiale në një kanal përreth rrugës. Teli u shtri përgjatë kanalit nga vendi ku ishte kutia dhe kanistra e deri tek një urë e afërt. Kutia dhe kanistra pastaj u mbuluan me diçka. Në këtë pikë dy nga pasagjerët e veturës u futën në pyllin pranë ndërsa dy pasagjerët e tjerë u kthyen në Mercedes dhe u larguan nga vendi i ngjarjes, duke e vozitur veturën në drejtim të Kosovës. Vëzhguesit qenë në gjendje të sigurojnë një përshkrim të përgjithshëm të të katër personave por nuk mund t'i shihnin qartë fytyrat e tyre.
- 15.3. Të nesërmen Mercedesi u shfaq sërish në zonën në fjalë kësaj radhe me dy persona të tjerë të cilët nuk kishin qenë të pranishëm një ditë më herët. Në fund erdhi po ashtu edhe një Golf Volkswagen dhe u ndal pranë Mercedesit. Ishte e pamundur të shihej kush ishte brenda në Golf. Pasagjerët e të dyja veturave zhvilluan pastaj një bisedë në mes tyre.
- 15.4. Në fund, u paraqitën dy burrat e pyllit. Në atë moment u bë e mundur të shikoheshin fytyrat e këtyre dy personave përmes dylbive dhe dylbisë teleskopike të një pushke snajper. Teli, kutia dhe kanistra për karburant u morën dhe prapë u kthyen në Mercedes. Dy burrat nga pylli u futën në Golf, duke u ulur në ulëset e pasme të Golfit. Dy të tjerë u futën në Mercedes dhe vozitën kah veriu në drejtim të pikës kufitare. Ndërsa tre burrat në Golf shkuan në drejtim të jugut për në Kosovë.
- 15.5. Kur Mercedesi nuk u ndal në pikën kufitare pasagjerët e veturës u qëlluan dhe u vranë nga rojat kufitare dhe nga kontrolli i mëvonshëm i veturës u zbulua prania e telit, e një baterie (akumulatori) të madh, e kanistrës me karburant dhe e një sasive të konsiderueshme të eksplozivit.
- 15.6. Ndërkohë, Golfi kishte vazhduar në drejtim të jugut nëpër rrugë të ndryshme derisa është ndalur nga ana e policisë. Në kohën e ndaljes së tij në veturë kishin qenë vetëm dy burra. I pandehuri nuk ishte në mesin e tyre. Shoferi i Golfit më vonë është identifikuar si babai i shoferit të Mercedesit, i cili ndërkohë tashmë ishte vrarë nga rojat e kufirit.

- 15.7. Përmes hetimeve në vazhdim i pandehuri është identifikuar si i pandehur përmes disa procedurave të fotove të rreshtuara të cilat u janë treguar njerëzve të cilët kishin vëzhguar aktivitetet e ndryshme pranë vendkalimit kufitar. Këto procedura dhe identifikimi i mëvonshëm i të pandehurit janë në qendër të vendimit të trupit gjykues prandaj edhe vetë thelbi i kësaj ankese.
- 15.8. Gjatë lirimit të të pandehurit trupi gjykues ka ardhur gjer tek këto tri gjetje konkrete: 1) faktet kanë provuar kryerjen e aktit terrorist; 2) faktet nuk kanë provuar se akti terrorist është kryer nga një organizatë terroriste; dhe 3) faktet nuk kanë provuar se i pandehuri J. ka qenë i përfshirë në kryerjen e aktit terrorist. Gjykata e Apelit vetëm i adresohet gjetjes së tretë të Gjykatës së Qarkut pasi që ajo lidhet me këtë ankese.
16. Çështja kryesore e ngritur nga prokuroria në ankesën e tyre është se trupi gjykues nuk iu ka dhënë rëndësi të mjaftueshme provave të dy dëshmitarëve anonimë të cilët kishin identifikuar të pandehurin përmes procedurave të ndryshme me foto të rreshtuara si njërin prej personave të përfshirë në aktivitetet e kundërligjshme pranë vendkalimit kufitar.
17. Ashtu siç e ka theksuar me të drejtë trupi gjykues në pjesën e arsytimit të aktgjykimit të tyre, dy personat e vetëm të cilët kishin qenë dëshmitarë të drejtpërdrejtë lidhur me përfshirjen e pohuar të të pandehurit në aktivitetet e kundërligjshme ishin dy ish-roja kufitare serbe të cilët, siç u tha më sipër, i kishin vëzhguar aktivitetet në fjalë përmes dylbive dhe përmes okularit teleskopik të pushkës snajper. Ata pastaj e kanë identifikuar të pandehurin pasi iu janë treguar disa nga fotografitë e rreshtuara gjë e cila trupit gjykues iu ka dukur e dyshimtë për shkak të llojit të fotove dhe për shkak të mundësisë se sa herë këto foto iu janë treguar dëshmitarëve në fjalë. Kolegji po ashtu e ka theksuar se në gjykim këta dy dëshmitarë anonimë e kanë zgjedhur foton e cila dukej se ishte e të pandehurit, por nuk kanë qenë në gjendje që ta identifikojnë kur e kanë parë në video monitor gjatë gjyqimit.
18. Përveç skepticizmit të trupit gjykues lidhur me besueshmërinë e proceseve të cilat lidhen me rreshtimin e fotove, kolegji po ashtu ka theksuar se e vetmja provë tjetër e cila ka mundësi ta lidhë të pandehurin me këtë çështje ka qenë dëshmia e pjesëtarit të suspenduar dhe të burgosur të Shërbimit Policor të Kosovës i cili e kishte ndryshuar disa herë rrëfimin e vet dhe i cili, në rastin më të mirë mund të besojmë se ka thënë se “kishte dëgjuar” se i pandehuri ishte përfshirë. Kolegji e ka refuzuar dëshminë e tij si tërësisht të pabesueshme. Kolegjit pa dyshim se ka arsye të justifikuara për të konstatuar se dëshmitari në fjalë ka besueshmëri shumë të ulët dhe se dëshmia e tij është e pabesueshme.
19. Gjykata më tej ka theksuar se të pandehurit e tjerë në gjykimet e veta të ndara madje kanë mohuar se njohin fare këtë të pandehur.

20. Gjykata e Apelit e Kosovës shpesh ka zbatuar parimin e përgjithshëm që kërkohet t'i tregohet respekt i konsiderueshëm gjetjes faktike të trupit gjykues pasi që ai trup i ka dëgjuar provat dhe ai trup është në pozitën më të mirë për t'i vlerësuar peshën dhe vlerën e atyre provave.¹ Përveç kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës është e pikëpamjes se duhet domosdo, "... ta respektojë vlerësimin e trupit gjykues lidhur me besueshmërinë e dëshmitarëve të gjykimit të cilët janë paraqitur personalisht para tyre dhe të cilët kanë dëshmuar personalisht para tyre. Nuk është e përshtatshme për Gjykatën Supreme që ta shkelë vlerësimin e trupit gjykues lidhur me vlerësimin e besueshmërisë së këtyre dëshmitarëve pa pasur një bazë të fortë për diçka të tillë." Gjykata më pastaj ka thënë se standardi që duhej zbatuar ka qenë "... mos t'i prekë gjetjet e gjykatës që ka zhvilluar gjykimin nëse provat në të cilat është mbështetur ajo gjykatë nuk kanë mundur të pranohen nga asnjë gjykatë e arsyeshme faktike, ose nëse vlerësimi i saj ka qenë në tërësi i gabueshëm."²
21. Këtu është e qartë se trupi gjykues me kujdes ka analizuar dhe ka peshuar provat, në veçanti dëshminë e dhënë nga ata të cilët i kishin dhënë provat me qëllim të lidhjes së të pandehurit me veprën penale. Duke pasur parasysh shqyrtimin e kujdesshëm të provave nga ana e trupit gjykues si dhe sqarimin e qartë të arsyeve të tyre për konstatimin se prokuroria nuk e kishte provuar se i pandehuri ka qenë i përfshirë në veprën penale, zbatimi i parimeve ligjore të përmendura më lart i ofron bazë të mjaftueshme kolegjit që t'i vërtetojë gjetjet e trupit gjykues dhe ta refuzojë ankesën e prokurorit.
22. Edhe pse zbatimi i parimeve ligjore të theksuara më lart është i mjaftueshëm për mbështetjen e gjetjeve të trupit gjykues dhe për vërtetimin e aktgjykimit të tyre, kolegji e ndjen se është e rëndësishme që të diskutohet një faktor tjetër të rëndësishëm lidhur me dëshmitarët anonimë.
23. Prokuroria ankohet në ankesën e saj se trupi gjykues nuk i kishte dhënë peshë të mjaftueshme deklaratave të dy dëshmitarëve anonimë të dhëna gjatë fazës paraprake hetimore. Duke e ngritur një gjë të tillë si arsye për ankesë është e dukshme se prokuroria ka injoruar plotësisht deklarinimin e qartë dhe konciz ligjor lidhur me përdorimin e dëshmisë së dëshmitarëve anonimë për provimin e fajësisë të bërë nga trupi gjykues në faqen 21 të aktgjykimit të kontestuar në versionin në gjuhën angleze.
24. Ashtu siç ka theksuar me të drejtë trupi gjykues, Kodi i procedurës penale të Kosovës në nenin 157 (3) ia ndalon gjykatës që ta shpallë dikë fajtor duke u bazuar vetëm apo në masë vendimtare në dëshmi të dhëna nga një dëshmitar i cili është anonim për të pandehurin dhe mbrojtësin e vet. Ashtu siç kishte theksuar kolegji në vazhdim kodi kosovar duket nga gjuha

¹ Shih për shembull, Gjykata e Apelit e Kosovës PAKR 1121/12, 25 shtator 2013, par. 48

² Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, par. 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012, par. 30

e përdorur që kjo vlen për dëshminë e një dëshmitari të vetëm anonim përderisa Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lëndën Doorson kundër shtetit të Holandës të datës 26 mars 1996 (20524/92) kishte thënë se madje edhe dëshmia e më shumë se një dëshmitari anonim është e pamjaftueshme.

25. Nuk është e qartë nga ankesa e prokurorit nëse prokuroria kërkon të bëjë dallimin në mes të deklaratave të dhëna para gjykimit nga dëshmitarët anonimë dhe të dëshmimeve të dhëna nga këta dëshmitarë gjatë gjykimit. Nëse ky është qëllimi, përpjekja për të bërë një dallim të tillë është e pabazë. Është e parëndësishme forma në të cilën dëshmitari anonim jep dëshmitë e veta. Pavarësisht mënyrës se si prezantohen dëshmitë fakti i dhënies së statusit anonim për një dëshmitar të caktuar do të thotë se këto dëshmi kurrë nuk mund të kontestohen në tërësi lidhur me vërtetësinë dhe besueshmërinë e tyre, prandaj, prandaj përdorimi i kësaj si provë kufizohet në mënyrë të ashpër.
26. Duke u mbështetur në të gjitha që u thanë, kolegji e refuzon ankesën e prokurorit dhe e vërteton gjetjen e trupit gjykues me të cilën i pandehuri shpallet i pafajshëm për të gjitha akuzat.

Përgatitur në gjuhën angleze si gjuhë e autorizuar. Aktgjykimi i arsyetuar është përfunduar dhe është nënshkruar më datën 25 prill 2014.

Kryetar i kolegjit

James Hargreaves

Gjyqtar i EULEX-it

Anëtare e kolegjit

Annemarie Meister

Gjyqtare e EULEX-it

Anëtar i kolegjit

Xhevdet Abazi

Gjyqtar

Procesmbajtës

Andres Parmas

Zyrtar ligjor i EULEX-it